



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** **Trupi Gjykses II**  
Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës  
Gjykatës Kristof Barte  
Gjykatës Ginel Metro  
Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 23 shtator 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Listës së Provave  
Materiale**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith  
Methju Halling  
Valeria Boliçi  
Xhejms Pejs

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bauden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman  
Karl Bakli

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në përputhje me nenin 40(6) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 116(4) dhe 118(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 korrik 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi listën konfidenciale të përditësuar të provave materiale të propozuara ("Lista e Provave Materiale").<sup>1</sup>

2. Më 21 korrik 2021, Trupi Gjykues nxori urdhrin për mbajtjen e konferencës përgatitore për gjykimin më 2 shtator 2021.<sup>2</sup> Me anë të këtij urdhri, Trupi Gjykues, ndërmjet të tjerave, urdhëroi ZPS-në që deri më 23 gusht 2021, të kërkojë verifikimin e saktësisë së një pjese të transkriptit të një prej provave materiale të propozuara ("081358-01-TR"), në lidhje me të cilën Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit") kishte ngritur kundërshtim në dosjen e vet paraprake.<sup>3</sup>

3. Më 1 dhe 2 shtator 2021, Trupi Gjykues mbajti Konferencën Përgatitore për Gjykimin. Gjatë konferencës, Trupi Gjykues ndërmjet të tjerave urdhëroi:

- (i) që deri më 7 shtator 2021, ZPS-ja të parashtrojë kërkesë për ndryshimin e listës së propozuar të dëshmitarëve, si dhe të nxjerrë çdo material provues në lidhje me ta dhe të kërkojë përfshirjen e atij materiali në

---

<sup>1</sup> F00254/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e Parashtrimit të Listës së Përditësuar të Provave Materiale – Lista e Përditësuar e Provave Materiale* ("Lista e Provave Materiale"), 6 korrik 2021, konfidenciale.

<sup>2</sup> F00267, Trupi Gjykues, *Urdhër për Parashtrime dhe për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykim* ("Urdhri për Konferencën Përgatitore për Gjykim"), 21 korrik 2021.

<sup>3</sup> Urdhri për Konferencën Përgatitore për Gjykim, para. 14, 34(c), që i referohet Listës së Provave Materiale, materiali nr. 33: ERN 081358-01-TR-ET faqja 8; F00258, *Dosje Paraprake e Mbrojtjes në Emër të Hysni Gucatit*, 12 korrik 2021, para. 98.

Listën e Provave Materiale, dhe që Mbrojtja të përgjigjet, nëse dëshiron, gjatë Konferencës Përgatitore të ZPS-së (“Urdhri i Katërt”);<sup>4</sup>

- (ii) që ZPS-ja të paraqesë kërkesë për përfshirjen e transkripteve të rishikuara në Listën e Provave Materiale dhe të nxjerrë materialin provues përkatës të mbetur deri më 13 shtator 2021, dhe që Mbrojtja të përgjigjet, nëse dëshiron, deri më 20 shtator 2021.<sup>5</sup>

4. Më 6 shtator 2021, ZPS-ja paraqiti një kërkesë për autorizimin e përfshirjes së dëshmitarit W04866 në listën e dëshmitarëve (“Kërkesa e Parë”) dhe të 29 materialeve në Listën e Provave Materiale (“Kërkesa e Dytë”), (së bashku, “Kërkesa”).<sup>6</sup>

5. Më 8 shtator 2021, Trupi Gjykses mbajti Konferencën Përgatitore të ZPS-së gjatë së cilës, në përputhje me Urdhrin e Katërt, dëgjoi parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me Kërkesën. Trupi Gjykses miratoi Kërkesën e Parë, duke qenë se, ndërmjet të tjerave, Mbrojtja nuk kundërshtoi përfshirjen e W04866-ës në listën e dëshmitarëve të ZPS-së.<sup>7</sup> Trupi Gjykses bëri me dije se vendimin mbi Kërkesën e Dytë do ta merrte pas marrjes së kërkesës së ZPS-së për përfshirjen e transkripteve të rishikuara në Listën e Provave Materiale.<sup>8</sup>

6. Më 13 shtator 2021, ZPS-ja nxori transkriptet e rishikuara të intervistës me W04866-ën.<sup>9</sup>

<sup>4</sup> Urdhër Gojor për Caktimin e Afatit të Dorëzimit të Kërkesës së ZPS-së për të Shtuar një Dëshmitar në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së, 2 shtator 2021, f. 602, rreshtat 11-20.

<sup>5</sup> Urdhër Gojor për Caktimin e Afatit për Dorëzimin e Kërkesës së ZPS-së për të Shtuar Transkripte në Listën e Provave Materiale, 2 shtator 2021, f. 602, rreshti 21 deri në f. 603, rreshti 4.

<sup>6</sup> F00299, ZPS, *Kërkesë e Prokurorisë për Plotësime në Listën e Dëshmitarëve dhe Listën e Provave Materiale të ZPS-së, me shtojcën 1, konfidenciale* (“Kërkesa”), 6 shtator 2021, me shtojcën 1 (“Shtojca”), konfidenciale.

<sup>7</sup> Urdhër Gojor mbi Listën e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale të ZPS-së, 8 shtator 2021, f. 707, rreshti 21 deri në f. 708, rreshti 14. *Shih edhe* Transkripti, 8 shtator 2021, f. 692, rreshti 4, f. 694, rreshti 21, f. 707, rreshtat 22-25.

<sup>8</sup> Urdhër Gojor për Listën e Dëshmitarëve dhe Provave Materiale të ZPS-së, 8 shtator 2021, f. 707, rreshti 21, f. 708, rreshti 14.

<sup>9</sup> ZPS, *Nxjerrja nr. 45 e materialeve*, 13 shtator 2021 (“*Nxjerrja nr. 45*”).

7. Më 15 shtator 2021, dy ditë pas përfundimit të afatit të zbatueshëm, ZPS-ja parashtrori kërkesën për përfshirjen e transkripteve të rishikuara të intervistës me W04866-ën në Listën e Provave Materiale dhe kërkoi leje për ta bërë një gjë të tillë (“Kërkesa e Mëtejshme”).<sup>10</sup>

8. Mbrojtja nuk parashtrori përgjigje.

## II. PARASHTRIMET

9. ZPS-ja parashtron se Kërkesa e Dytë duhet të miratohet pasi materialet shtesë që propozon t’i përfshijë në Listën e Provave Materiale janë të kufizuara, u shërbejnë interesave të drejtësisë dhe nuk cenojnë ose nuk bien ndesh me të drejtat e të akuzuarve.<sup>11</sup>

10. ZPS-ja parashtron argumente për katër kategoritë e provave materiale shtesë që kërkon t’i përfshijë në Listën e Provave Materiale të saj, përkatësisht: (i) transkriptet dhe përkthimin e intervistës me W04866-ës dhe provat materiale shoqëruese;<sup>12</sup> (ii) transkriptin dhe përkthimin, të rishikuara, të 081358-01-TR;<sup>13</sup> (iii) transkriptet dhe përkthimin e vidematerialit 081991-04;<sup>14</sup> dhe (iv) pjesë të Paketës 1 dhe Paketës 3 të ribotuara në artikuj dhe videomateriale mediash.<sup>15</sup>

<sup>10</sup> F00313, ZPS, *Kërkesa e Prokurorisë për të Shtuar Transkriptet e Rishikuara të Intervistës me W04866-ën në Listën e Provave Materiale*, 15 shtator 2021.

<sup>11</sup> Kërkesa, para 1, 8.

<sup>12</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 5 (i), 17, që i referohet 102781-TR-ET Part 1 RED; 102781-TR-ET Part 2 RED; 102781-TR-AT Part 1 RED; 102781-TR-AT Part 2 RED; 102766-102780; 102766-102780-ET.

<sup>13</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 20 që i referohet 081358-01-TR-ET 081358-01-TR-AT Revised 01; 081358-01-TR-ET-Revised.

<sup>14</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 24, që i referohet 081991-04-TR-ET; 081991-04-TR-ATK

<sup>15</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 27, që i referohet 080464-080464; 080565-080565 RED; 080992-080992; 081031-081031; 081083-081083 RED; SPOE00220920-SPOE00220928; SPOE00220946-SPOE00220947 RED; SPOE00220961-SPOE00220961; SPOE00221063-SPOE00221063 RED; SPOE00221065-SPOE00221066 RED; SPOE00221072-SPOE00221072 RED; SPOE00221078-SPOE00221078 RED; SPOE00222289-SPOE00222297; SPOE00222315-SPOE00222316 RED; SPOE00222330-SPOE00222330; SPOE00222433-SPOE00222433 RED; SPOE00222435-SPOE00222436 RED; SPOE00222442-SPOE00222442 RED; SPOE00222448-SPOE00222448 RED. Paketat 1 dhe 3 u referohen dokumenteve që ZPS-ja sekuestroi nga Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL UÇK”) më 8 dhe 22 shtator

11. Mbrojtja ngriti një sërë kundërshtimesh në lidhje me përfshirjen e disa provave materiale në Listë, të cilat do të merren në shqyrtim më poshtë.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Në përputhje me rregullën 116(4) të Rregullores, Trupi Gjykes mund të lëshojë çfarëdo urdhrash apo vendimesh të nevojshme për garantimin e një gjykimi të drejtë, të paanshëm e të shpejtë, përfshirë në lidhje me detyrimet për nxjerrjen e materialit dhe çfarëdo çështjesh të tjera përgatitore të nevojshme.

13. Rregulla 95(4)(a) e Rregullores parashikon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të urdhërojë Prokurorin e Specializuar që brenda një afati të caktuar të paraqesë listën e propozuar të provave materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë. Në përputhje me rregullën 118(2) të Rregullores, pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, Trupi Gjykes mund të lejojë ndryshimin e listës së provave materiale.

### IV. DISKUTIM

#### A. PARAQITJA E KËRKESËS SË MËTEJSHME

14. Paraprakisht, dhe duke pasur parasysh se nuk ka kundërshtime nga Mbrojtja, Trupi Gjykes e pranon Kërkesën e Mëtejshme si të vlefshme megjithëse është paraqitur jashtë afatit.

#### B. STANDARDI LIGJOR

15. Fillimisht, Trupi Gjykes thekson se qëllimi kryesor i Listës së Provave Materiale është që Mbrojtja të njoftohet për dokumentet të cilat ZPS-ja synon t'i

---

2020. *Shih F00141, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve të Sekuestruara nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së, 23 shkurt 2021.*

përdorë gjatë paraqitjes së provave të saj, çka mundëson përgatitjen efektive dhe në kohë të Mbrojtjes dhe garanton paraqitjen efikase të provave gjatë gjykimit.<sup>16</sup>

16. Trupi Gjykues do të vlerësojë nëse në këtë fazë të procesit: (i) provat materiale të propozuara janë *prima facie* relevante dhe me rëndësi të mjaftueshme për të përligjur përfshirjen me vonesë të tyre;<sup>17</sup> (ii) provat shtesë të propozuara u ofrojnë të akuzuarve informacion të mjaftueshëm dhe nuk ndikojnë negativisht në mundësinë e tyre për t'u përgatitur për gjykim;<sup>18</sup> dhe (iii) ZPS-ja ka treguar arsye të vlefshme për kërkesën e paraqitur me vonesë.<sup>19</sup> Në marrjen e vendimit në lidhje me autorizimin e përfshirjes së një materiali në listën e provave materiale të një pale, nuk është e nevojshme që Trupi Gjykues të vlerësojë autenticitetin, rëndësinë dhe vlerën provuese të atij materiali në të njëjtën mënyrë si gjatë marrjes së vendimit për pranimin e tij si provë gjatë gjykimit.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, vendimi që autorizon përfshirjen e një materiali në listën e provave materiale të një pale nuk cenon vendimin vijues të Trupit Gjykues nëse një material i tillë duhet të pranohet apo jo si provë. Megjithatë, një pale nuk duhet t'i autorizohet leje që në listën e vet të provave materiale të përfshijë materiale që janë dukshëm të parëndësishme dhe të cilat për këtë arsye në fund nuk do të pranohen si prova.<sup>21</sup>

17. Në këtë çështje, Mbrojtja nuk ka sugjeruar që ndonjë nga provat shtesë të propozuara është e parëndësishme dhe Trupi Gjykues është bindur se *prima facie* ato të gjitha lidhen me çështjen. Në përputhje me këtë, Trupi Gjykues në vijim do

<sup>16</sup> Në mënyrë të ngjashme ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, [Decision on Prosecution's Motion for Leave to Amend its Exhibit List](#) ("Karadžić Decision"), 19 tetor 2011, para. 10.

<sup>17</sup> Në mënyrë të ngjashme ICTY/TPNJ, [Karadžić Decision](#), para. 9; *Prosecutor v. Hadzić*, IT-04-75-T, [Decision on Fifth Defence Motion for Leave to Amend its Rule 65 ter Exhibit List](#) ("Hadzić Decision"), 19 shkurt 2015, para. 5; STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/T/TC, [Decision allowing the Prosecution to Add to Its Exhibit List a Statement by Mr Andrew Donaldson \(Witness PRH230\)](#) ("Ayyash Decision"), 28 prill 2017, para. 18.

<sup>18</sup> Në mënyrë të ngjashme ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Dragomir Milošević*, IT-98-29/1-T, [Decision on Prosecution's Third Motion for Leave to Amend Its Rule 65 ter Exhibit List](#) ("Milošević Decision"), 23 prill 2007, f. 3; [Karadžić Decision](#), para. 9; STL, [Ayyash Decision](#), para. 18.

<sup>19</sup> Rregulla 118(2) e Rregullores. Në mënyrë të ngjashme, ICTY/TPNJ, [Milošević Decision](#), p. 3.

<sup>20</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICTY/TPNJ, [Karadžić Decision](#), para. 10; [Hadzić Decision](#), para. 5.

<sup>21</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICTY/TPNJ, [Karadžić Decision](#), para. 10; [Hadzić Decision](#), para. 5.

të shqyrtojë secilën prej katër kategorive të provave materiale që ZPS-ja synon t'i përfshijë në Listën e Provave Materiale të ZPS-së.

C. TRANSKRIPTET DHE PËRKTHIMI I INTERVISTËS ME W04866-ËN DHE PROVAT MATERIALE SHOQËRUESE

18. Gjashtë materialet e kësaj kategorie përfshijnë: (i) transkriptet dhe përkthimin e intervistës me W04866-ën dhe (ii) kopjet e artikujve ku W04866 është autor, si dhe përkthimet në anglishte të tyre.<sup>22</sup>

19. Në lidhje me këto materiale, ZPS-ja parashtron se ato kanë rëndësi dhe vlerë të lartë provuese në lidhje me veprimet e pretenduara të të akuzuarve, dhe se provat materiale shoqëruese nuk cenojnë të akuzuarit duke qenë se pasqyrojnë informacion që është tashmë nën zotërimin e Mbrojtjes.<sup>23</sup> Mbrojtja e Gucatit kundërshton përfshirjen e këtyre materialeve shtesë, bazuar në faktin se W04866 do të dëshmojë me gojë.<sup>24</sup> Mbrojtja e Nasim Haradinajt i bashkohet qëndrimit të Mbrojtjes së Gucatit në lidhje me këtë pikë.<sup>25</sup>

20. Në lidhje me relevancën dhe rëndësinë e tyre të mjaftueshme *prima facie*, Trupi Gjykses vëren se këto materiale kanë të bëjnë me ngjarje të lidhura me dorëzimin dhe publikimin e pretenduar të materialit të ZPS-së/TFHS-së në shtator 2020, përfshirë pjesëmarrjen e W04866-ës në konferencën e parë për shtyp më 7 shtator 2020. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se materialet kanë rëndësi të mjaftueshme *prima facie* për të përligjur përfshirjen e tyre të vonuar.

---

<sup>22</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 17, që i referohet 102781-TR-ET Part 1; 102781-TR-ET Part 2; 102781-TR-AT Part 1; 102781-TR-AT Part 2; 102766-102780; 102766-102780-ET.

<sup>23</sup> Kërkesa, para. 9

<sup>24</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 694, rreshtat 4-11.

<sup>25</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 694, rreshtat 19-21.

21. Në lidhje me ndikimin e përfshirjes së kërkuar të këtyre materialeve shtesë në përgatitjen e të akuzuarve për gjykim, Trupi Gjykses vëren se: (i) Mbrojtja tashmë ka në zotërim materialin e nxjerrë që pasqyron përmbajtjen e provave materiale shoqëruese;<sup>26</sup> (ii) numri dhe vëllimi i materialeve është i tillë që mundëson përgatitjen në kohë dhe të mirëfilltë për gjykim, veçanërisht duke pasur parasysh urdhrin me gojë të Trupit Gjykses për të dëgjuar dëshmitarin W04866 si të fundit ndër tre dëshmitarët e ZPS-së;<sup>27</sup> dhe (iii) sido që të jetë, Mbrojtja do të ketë mundësinë t'i drejtojë pyetje W04866-ës.<sup>28</sup> Në lidhje me kundërshtimin e ngritur nga Mbrojtja e Gucatit, Trupi Gjykses rithekson se përfshirja e materialeve shtesë në Listën e Provave Materiale i shërben qëllimit të informimit të Mbrojtjes për materialet që ZPS-ja synon të përdorë gjatë paraqitjes së provave të saj dhe nuk nënkupton pranimin e materialeve përkatëse si prova. Trupi Gjykses konstaton se përfshirja e kërkuar e materialeve shtesë u ofron të akuzuarve informacion të mjaftueshëm dhe nuk ndikon negativisht në aftësinë e tyre për t'u përgatitur për gjykim.

22. Në lidhje me arsyet e vlefshme për paraqitjen me vonesë të kërkesës për ndryshimin e Listës së Provave Materiale, Trupi Gjykses vëren se kërkesa është bërë dymbëdhjetë ditë pas intervistës me W04866-ën dhe një muaj para fillimit të paraqitjes së provave të ZPS-së. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se kërkesa ka të bëjë me transkriptet e parishikuara të intervistës me W04866-ën dhe se ZPS-ja paraqiti kërkesën e saj të mëtejshme në lidhje me transkriptet e rishikuara dy ditë pas përfundimit të afatit të caktuar nga Trupi Gjykses. Duke i vënë në dukje ZPS-së rëndësinë e paraqitjes në kohë të parashtrimeve, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja

---

<sup>26</sup> *Shih* ZPS, *Nxjerrja nr. 7*, 19 shkurt 2021; Kërkesa, para. 9, poshtëshënimi 11.

<sup>27</sup> Urdhër Gojor mbi Listën e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale të ZPS-së, 8 shtator 2021, f. 707, rreshti 21 deri në f. 708, rreshti 14.

<sup>28</sup> Urdhër Gojor mbi Listën e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale të ZPS-së, 8 shtator 2021, f. 707, rreshti 21 deri në f. 708, rreshti 14. *Shih edhe* Transkripti, 8 shtator 2021, f. 692, rreshti 24, f. 694, rreshti 21, f. 707, rreshtat 22-25.



nxori transkriptet e rishikuara brenda afatit të zbatueshëm.<sup>29</sup> Është në interesin e të gjitha palëve që Lista e Provave Materiale të pasqyrojë versionin më të saktë të provave materiale të propozuara. Si rezultat, Trupi Gjykes konstaton se ZPS-ja ka dhënë arsye të vlefshme për paraqitjen me vonesë të kërkesës.

23. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes autorizon përfshirjen e transkripteve dhe përkthimeve të rishikuara të intervistës së W04866-ës, si dhe të provave materiale shoqëruese, në Listën e Provave Materiale.

#### D. TRANSKRIPTI DHE PËRKTHIMI I RISHIKUAR I 081358-01-TR

24. Dy materialet në këtë kategori janë transkripti i rishikuar në gjuhën shqipe dhe përkthimi përkatës në anglishte i një materiali filmik të marrë nga *YouTube* ku paraqitet Hysni Gucati më 7 shtator 2020. Versionet e mëparshme të këtyre transkripteve janë tashmë të përfshira në Listën e Provave Materiale.<sup>30</sup>

25. Në lidhje me këto materiale, ZPS-ja parashtron se ato nuk e dëmtojnë Mbrojtjen pasi versioni i rishikuar i tyre është pasojë e urdhrit të Trupit Gjykes drejtuar ZPS-së për verifikimin e saktësisë së transkripteve dhe përkthimit në fjalë, urdhër të cilin e kërkoi vetë Mbrojtja.<sup>31</sup> Mbrojtja nuk bëri parashtrime për këtë pikë.

26. ZPS-ja kërkon përfshirjen e versioneve të rishikuara të këtyre dy materialeve<sup>32</sup> rishikimi i të cilave, siç u rikujtua më lart, ishte pasojë e Urdhrit për Konferencën Përgatitore për Gjykimin, me kërkesë të Mbrojtjes së Gucatit.<sup>33</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykes konstaton se këto dy materiale kanë relevancë dhe rëndësi të mjaftueshme *prima facie* për të përlegjur përfshirjen me vonesë të tyre në Listën e

---

<sup>29</sup> *Nxjerrja nr. 45.*

<sup>30</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 20, që i referohet 081358-01-TR-ET 081358-01-TR-AT Revised 01; 081358-01-TR-ET-Revised.

<sup>31</sup> Kërkesa, para. 10. *Shih edhe* Urdhri për Konferencën Përgatitore për Gjykimin, para 14, 34(c).

<sup>32</sup> Kërkesa, para. 11.

<sup>33</sup> *Shih më lart*, para. 2.

Provave Materiale dhe se kjo nuk ndikon negativisht në përgatitjen e Mbrojtjes. Për të njëjtën arsye, siç përmendet më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka treguar arsye të vlefshme për paraqitjen me vonesë të kërkesës për ndryshimin e Listës së Provave Materiale në lidhje me këto materiale.

27. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses autorizon përfshirjen e të dy transkripteve të rishikuara në Listën e Provave Materiale.

#### E. TRANSKRIPTET DHE PËRKTHIMI I VIDEOS 081991-04

28. Dy materialet në këtë kategori janë transkripti në gjuhën shqipe dhe përkthimi përkatës në anglishte i videomaterialit 081991-04 (“videomateriali”) që përmban një intervistë me Nasim Haradinajn.<sup>34</sup>

29. Në lidhje me këto materiale, ZPS-ja parashtron se ato janë hequr padashur nga Lista e Provave Materiale dhe se cenimi i shkaktuar nga përfshirja e tyre do të ishte minimal për Mbrojtjen pasi: (i) këto materiale janë nxjerrë tashmë në përputhje me rregullën 102(1)(b) të Rregullores; (ii) videomateriali përkatës është në Listën e Provave Materiale; dhe (iii) ZPS-ja i është referuar videomaterialit dhe transkripteve përkatëse në dosjen paraprake.<sup>35</sup> Mbrojtja nuk bëri parashtrime në këtë aspekt.

30. Trupi Gjykses konstaton se këto materiale kanë relevancë dhe rëndësi të mjaftueshme *prima facie* për të përligjur përfshirjen me vonesë të tyre dhe se kjo nuk ndikon negativisht në përgatitjen e Mbrojtjes. Trupi Gjykses vëren se: (i) videomateriali ishte tashmë në Listën e Provave Materiale;<sup>36</sup> (ii) Mbrojtjes i është nxjerrë transkripti dhe përkthimi i videomaterialit në përputhje me rregullën 102(1)(b)

---

<sup>34</sup> Kërkesa, poshtëshënimi 24, që i referohet 081991-04-TR-ET; 081991-04-TR-AT.

<sup>35</sup> Kërkesa, para. 11.

<sup>36</sup> Lista e Provave Materiale, materiali 130.

të Rregullores;<sup>37</sup> dhe (iii) ZPS-ja i është referuar si videomaterialit, ashtu edhe transkripteve përkatëse, në dosjen e saj paraprake.<sup>38</sup>

31. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses autorizon përfshirjen e këtyre materialeve në Listën e Provave Materiale.

F. EKSTRAKTET NGA PAKETAT 1 DHE 3 TË RIBOTUARA NË ARTIKUJ DHE VIDEOMATERIALE MEDIASH

32. 19 materialet në këtë kategori duket se janë ekstrakte nga dokumentet në Paketat 1 dhe 3, të cilat pretendohet se u ribotuan në artikuj dhe videomateriale mediash. ("ekstraktet").<sup>39</sup>

33. Në lidhje me këto materiale, ZPS-ja parashtron se ato duhet të përfshihen në Listën e Provave Materiale pasi: (i) ndihmojnë Trupin Gjykses në marrjen e vendimit në lidhje me akuzat e ngritura kundër të akuzuarve; (ii) kanë lidhje me dëshminë e W04841-shit, i cili bëri një deklaratë në këtë drejtim; (iii) nuk e dëmtojnë Mbrojtjen e cila ka tashmë në zotërim deklaratën e W04841-shit, si dhe artikujt dhe videomaterialet ku paraqiten këto ekstrakte.<sup>40</sup> Mbrojtja nuk paraqiti parashtrime në këtë aspekt.

34. Për sa i përket relevancës dhe rëndësisë së mjaftueshme *prima facie*, Trupi Gjykses vëren se këto materiale duket se kanë lidhje me shpërndarjen e pretenduar të materialeve të TFHS-së/ZPS-së nga organe të mediave dhe për pasojë mund të kenë rëndësi për dëshminë e W04841-shit, siç përshkruhet nga

<sup>37</sup> ZPS, *Nxjerrja nr. 7*, 19 shkurt 2021.

<sup>38</sup> F00181/A01, ZPS, *Dosje Paraprake e Prokurorit të Specializuar në Çështjen kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, 9 prill 2021, para. 72, poshtëshënimi 195, para. 175, poshtëshënimi 408.

<sup>39</sup> Kërkesa, poshtëshënimi. 27, që i referohet 080464-080464; 080565-080565 RED; 080992-080992; 081031-081031; 081083-081083 RED; SPOE00220920-SPOE00220928; SPOE00220946-SPOE00220947 RED; SPOE00220961-SPOE00220961; SPOE00221063-SPOE00221063 RED; SPOE00221065-SPOE00221066 RED; SPOE00221072-SPOE00221072 RED; SPOE00221078-SPOE00221078 RED; SPOE00222289-SPOE00222297; SPOE00222315-SPOE00222316 RED; SPOE00222330-SPOE00222330; SPOE00222433-SPOE00222433 RED; SPOE00222435-SPOE00222436 RED; SPOE00222442-SPOE00222442 RED; SPOE00222448-SPOE00222448 RED.

<sup>40</sup> Kërkesa, para. 13, që i referohet ERN 084015-084026 (Deklarata e W04841-shit, 29 tetor 2020).

ZPS-ja.<sup>41</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se këto materiale kanë relevancë dhe rëndësi të mjaftueshme *prima facie* për të përligjur përfshirjen me vonesë të tyre.

35. Në lidhje me ndikimin e përfshirjes së këtij materiali shtesë në përgatitjen e të akuzuarve për gjykim, Trupi Gjykses vëren se: (i) Mbrojtja ka tashmë në zotërim deklaratën e W04841-shit që i referohet shpërndarjes së pretenduar të materialit nga organet e medias; (ii) numri dhe vëllimi i ekstrakteve janë të tilla që mundësojnë përgatitjen në kohë dhe të mirëfilltë për gjykim; dhe (iii) Mbrojtja do të ketë mundësi t'i drejtojë pyetje W04841-shit në lidhje me këto materiale.<sup>42</sup> Për këtë arsye Trupi Gjykses konstaton se përfshirja e kërkuar i jep njoftim të mjaftueshëm të akuzuarve dhe nuk ndikon negativisht në aftësinë e tyre për t'u përgatitur për gjykim.

36. Për sa u takon arsyeve të vlefshme për paraqitjen me vonesë të kërkesës, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nxori ekstraktet më 6 shtator 2021 vetëm si rezultat i "disa problemeve të ngritura nga Mbrojtja dhe Trupi Gjykses" dhe bëri me dije se është autorizuar të mos nxjerrë Paketat 1 dhe 3.<sup>43</sup> Sidoqoftë, ZPS-ja nuk ka dhënë arsye konkrete se përse ekstraktet ishte e mundur të nxirreshin më 6 shtator 2021, por jo në një datë më të hershme. Pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk kundërshton përfshirjen e ekstrakteve në Listën e Provave Materiale dhe se Mbrojtja do të ketë mundësi t'i drejtojë pyetje W04841-shit për këto materiale.

37. Për këtë arsye, Trupi Gjykses autorizon përfshirjen e ekstrakteve në Listën e Provave Materiale.

---

<sup>41</sup> F00181/A02, Prokurori i Specializuar, Shtojca 2 e Parashtrimit të Dosjes Paraprake, Listave të Dëshmitarëve e Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c) – Lista e Dëshmitarëve, 9 prill 2021, f. 2, para. 2.

<sup>42</sup> *Shih* ERN 084015-084026 (Deklarata e W04841-shit, 29 tetor 2020), f 2-4, 7-11.

<sup>43</sup> Kërkesa, para. 12; ZPS, *Nxjerrja nr. 44*, 6 shtator 2021.

## V. RIKLASIFIKIMI

38. Duke pasur parasysh se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Kërkesës dhe shtojcës së saj dhe se Kërkesa e Parë është miratuar,<sup>44</sup> Trupi Gjykes do të urdhërojë riklasifikimin e tyre si publike, në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

## VI. VENDIM

39. Për arsyet e mësipërme, Trupi Gjykes:

- a. **MIRATON** Kërkesën e Dytë;
- b. **URDHËRON** ZPS-në që deri më 28 shtator 2021 të parashtrojë listën e ndryshuar të provave materiale në përputhje me vendimin aktual; dhe
- c. **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Kërkesën (F00299) dhe shtojcën e saj (F00299/A01), si publike.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E enjte, 23 shtator 2021

Hagë, Holandë

---

<sup>44</sup> Kërkesa, para. 14.